



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.41

Prishtinë, më 06.11.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N/204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Frashër Krasniqi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Bilall Sherifi, Shkumbin Demaliaj dhe Jelena Bontiq!

Munguan: Sami Kurteshi dhe Bahrim Shabani.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Shaban Murturi, Lukas Korecki, Vera Manveno, Edita Kusari, Blerta Bejtullahu, EUSR/EUO; Erblina Ajazi, praktikante-Kuvend; Aferdita Smajli Kalaja, EU Office; Rreze Hoxha, GLPS; Bekim Kodraliu, OSBE; Albert Bislimi, EO; Genc Nimani, Çohu; Erblina Sejdiu, praktikante-Kuvend; Labinot Leposhtica, BIRN; Etrur Maloku dhe Adem Gashi, Ambasada Amerikane; Gözim Zejnullahu, AKKUP; Egzon Murturi, KDI dhe Televizioni T7.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.09.2018;
3. Votimi në parim i Projektligjit nr.06/L-110 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projekt-Kodin Penal të Republikës së Kosovës nr.06/L-074;

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
6. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore nr. 06/L-007 dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë nr. 06/L-008;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.09.2018

Kryetarja konstatoi se miratohet procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 19.09.2018, pa vërejtje.

3. Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-110 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Kryetarja tha se në takimin e fundit është votuar projektligji, pra debati është shterur, por njoftoi se nga këshillat e marra nga zyra ligjore e Kuvendit projektligji nuk ka kaluar sepse nga tetë anëtarë, sa kanë qenë të pranishëm në komision është dashur që pesë të votojnë në mënyrë që të konsiderohet që i njëjti ka kaluar. Kryetarja tha se duhet të votohet sërish për këtë projektligj.

Hajdar Beqa tha se duhet të shikohet praktika edhe e komisioneve të tjera në lidhje me standardin e votimit me 2/3 e votave në komision, sepse vetëm komisioni për Legjislacion është duke e praktikuar këtë votim në këtë mënyrë, prandaj duhet të kërkohet sqarim edhe nga zyra ligjore e Kuvendit lidhur me këtë çështje, theksoi Hajdar Beqa.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të mos miratohet në parim, Projektligji nr. 06/L-110 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projekt-Kodin Penal të Republikës së Kosovës nr.06/L-074

Kryetarja paraqiti para anëtarëve të komisionit amendamentet të cilat kanë mbetur të diskutohen në komision si vijon:

Amendamentet 11,13,14 dhe çështja e hyrjes në fuqi.

Hajdar Beqa, si kryesues i grupit punues për Projekt-Kodin Penal duke falënderuar të gjithë aktorët për kontributin theksoi se është bërë një punë e mirë. Tha se janë 79 amendamente dhe si kryesues i grupit punues kërkoi që të gjitha amendamentet që kanë pasur përkrahjen e grupit punues të përkrahen nga komisioni, kurse amendamentet të cilat nuk e kanë pasur përkrahjen e grupit, të mos marrin përkrahjen e komisionit. Pra, janë disa çështje që kanë mbetur të diskutohen edhe njëherë.

Kryetarja tha se ka bërë tri propozime, ku dy prej tyre kanë pasur përkrahjen e grupit punues, ndërsa propozimi i tretë e që është neni 62, amendamenti 11, konsideroj që është e nevojshme që të përfshihet në Kodin Penal.

Hajdar Beqa tha se tek amendamenti i z. Haxhiu, propozoi që të mbetet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë.

Bilall Sherifi tha se duhet të përdoret çdo mjet ligjor i cili ua ngushton rrethin ushtruesve të dhunës në familje. Më pas tha se e mbështet amendamentin e znj. Haxhiu.

Frashër Krasniqi tha se nuk ka ndonjë dëm nëse ky nen qëndron në Kodin Penal, përkundrazi ka vetëm ritheksimit të asaj që Republika e Kosovës duhet ta luftojë dhunën në familje, besoj që në lidhje me futjen si një kapitull i veçantë që flet për dhunën në familje është bërë një punë e mirë, ai tha se mbështet propozimin e znj. Haxhiu.

Amendamenti 11- Propozim i Albulena Haxhiut.

Me 4 (katër) vota për, asnjë kundër dhe 3 (tre) abstenime, përkrahet amendamenti i deputetes Albulena Haxhiu

Amendamenti 13- Propozim i Frashër Krasniqit.

Frashër Krasniqi tha se e ka bërë këtë propozim së bashku edhe me ekspertë të tjerë dhe profesorë që kanë marrë pjesë në hartimin e Kodit Penal. Nuk është korrekte që ta llogarisim një ditë paraburgim të barabartë më një ditë burgim, sepse një ditë e mbajtur në paraburgim është shumë ma e rëndë se një ditë e mbajtur në burg, pra ka 23 orë izolim me vetëm 1 orë shëtitje. Z. Krasniqi tha se ky ndryshim është në përputhje, madje e fuqizon respektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, kur dihet se ka problem me paraburgime dhe me tej zgjatjen e tyre, gjithashtu shtoi duke thënë se është në përputhje edhe me vendet e tjera që kanë politika më sociale ose rehabilituese në raport me institucionet korrektuese. Në fund deputeti Frashër Krasniqi i bëri thirrje komisionit që ta mbështesin këtë propozim.

Korab Sejdiu tha se kjo ka të bëjë me faktin se si duhet kalkuluar koha e mbajtur në paraburgim. Propozuesi ka të drejtë kur thotë që regjimi është i ndryshëm karshi atyre të cilët vuajnë dënimin pas aktgjykimit të formës së prerë, por duhet të jetë e qartë se arsyeja pse jepet paraburgimi ndër të tjera janë për shembull: ndikimi në dëshmitar, shkatërrimi i provave, rreziku i ikjes, mundësia e përsëritjes së veprës, pikërisht këto janë disa prej arsyeve të cilat edhe e justifikojnë një regjim pak më strikt se sa atë që ndodh pas kryerjes së procedurës, theksoi deputeti Korab Sejdiu. Duke pasur parasysh problemet që i kemi në vendin tonë me çështjet penale dhe veprat që po kryhen, nuk mundem me e përkrahur këtë propozim, që në fakt i shpërblen ata të cilët dënohen me vendim të formës së prerë, tha në fund z. Sejdiu.

Bilall Sherifi tha se nuk është se nuk ka të drejtë propozuesi kur thotë që paraburgimet jepen shumë lehtë dhe shumë gjatë njerëzit mbahen në paraburgim. Paraburgimi është mjeti adekuat për t'iu kundërvënë kësaj çështje. Z. Sherifi tha se nuk e sheh si mjet adekuat rritjen e vlerës së një dite paraburgim me vlerën e një dite në burg. Më pas tha se duhet të përforcojmë ligje të tjera të cilat i detyrojnë të jenë më korrekt ata që i shqiptojnë masat vend e pa vend. Ne duhet të përforcojmë sistemin në mënyrë që paraburgimi të jetë sa më pak raste, pra vetëm aty ku është i domosdoshëm dhe jo në të gjitha rastet, siç është bërë ndër vite, theksoi Bilall Sherifi.

Frashër Krasniqi theksoi se nuk ka për qëllim me larguar paraburgimin si masë sepse dihet që është e nevojshme në zhvillimin e një procedure penale. Mirëpo në parim i bie që njerëzit që dënohen, kanë bërë një parapagim gjatë kohës së paraburgimit. Ky parapagim kushton më shumë se sa pagesa që e bëjnë ata kur shkojnë në burg. Një ditë paraburgim e ka vlerën 30 euro, ndërsa një dite burgim e ka vlerën 20 euro dhe nëse mbahen 1 vit paraburgim, nuk është e barabartë sikur me i mbajte 1 vit burgim, pavarësisht veprës që është kryer potencoi Krasniqi.

Korab Sejdiu sqaroi duke thënë se është i vetëdijshëm për procedurën strikte e cila ekziston gjatë procedurës së paraburgimit, por arsyeja pse paguhet më shumë në paraburgim është për faktin se ekziston rreziku i ikjes, mundësia e ndikimit në prova, në dëshmitar etj. dihet se në Kosovë është abuzim total i të drejtave të njeriut kjo çështje e paraburgimit, por si komision mund të ftojme përfaqësuesit nga Këshilli Gjyqësor që të trajtohet kjo çështje, gjithashtu mund të kërkojmë përgjegjësi pse nuk zbatohet Kodi i Procedurës Penale në lidhje me dhënien e paraburgimit në përgjithësi, theksoi Korab Sejdiu.

Shkumbin Demaliaj tha se te praktika e gjyqësorit tonë me këtë nen rëndohet shumë Kodi Penal, sidomos në rastet e rënda penale apo bashkim të veprave penale, kjo ndikon shumë tek afati i dënimit për të paraburgosurit.

Arben Gashi tha se në analizën që është kërkuar nga ana jonë që të shohim se sa vende nga Bashkimi Evropian e ka një organizim të tillë, po rezulton se përveç Shqipërisë nuk ka vende tjera. Elementi tjetër që vlen të theksohet se nuk ka po ashtu një analizë të vendit tonë se në çfarë lloj veprash penale ndikon kjo, cilat kategori i prek më shumë dhe sa është mesatarja e ndikimit në veprat penale të cilat janë shqiptuar. Më pas ai vazhdoi duke thënë se pajtohet me deputetin Krasniqi se gjendja emocionale, gjendja shpirtërore, raportet me familjen, janë më të rënda se sa te të burgosurit, prandaj se ideja e sistemit nuk është të dënohen, por të riedukohen që këta persona të jenë të gatshëm të rikthehen në shoqëri. Ai tha se praktikisht është problem të trajtohet kjo çështje meqë LDK është ende në një fazë ku nuk merr pjesë në votime, ai tha se nuk do të votoj as për, as kundër.

Frashër Krasniqi kërkoi që të votohet kjo pikë së paku që t'iu shkoj deputetëve, me të gjitha vërejtjet që janë dhënë dhe pastaj të diskutohet në Kuvend.

Kryetarja- tha se e përkrahë këtë propozim, dhe do të votojë për.

Kryetarja konstatoi se amendamentet 13,14, me 2 (dy) vota për, 3 (tre) kundër dhe 2 (dy) abstenime, nuk përkrahen.

Amendamenti 47, dy propozime A dhe B

Përkrahet propozimi A i grupit punues.

Amendamenti 79

Kryetarja tha se propozimi i Ministrisë së Drejtësisë ka qenë që Kodi Penal i Republikës së Kosovës hyn në fuqi 3 muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Kryetarja konstatoi se ky amendament përkrahet, me 4 (katër) vota për, 1 (një) kundër dhe 2 (dy) abstenime.

Pas diskutimit të amendamenteve, kryetarja konstatoi se komisioni me shumicë votash nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Projekt-Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074
- II. Raporti me amendamente i paraqitet për shqyrtim Komisioneve Kryesore dhe procedohet për shqyrtim në Kuvend
- III. Amendamentet e miratuara dhe të pa miratuara janë aneks i këtij procesverbali.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

Kryetarja paraqiti para anëtarëve të komisionit amendamentet të cilat kanë mbetur të diskutohen në komision si vijon:

Amendamenti 27

Kryetarja- njoftoi së në këtë amendament janë dy propozime, A dhe B.

Kryetarja konstatoi se me katër vota për, dhe tre kundër përkrahet propozimi A.

Kryetarja- njoftoi se te dispozitat kalimtare janë dy propozime, A dhe B.

Kryetarja konstatoi se me katër vota për, një kundër dhe një abstenim përkrahet propozimi A.

Pas diskutimit të amendamenteve, kryetarja konstatoi se komisioni me pesë vota për dhe dy abstenime nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- II. Raporti me amendamente i paraqitet për shqyrtim Komisioneve Kryesore dhe procedohet

për shqyrtim në Kuvend;

III. Amendamentet e miratuara dhe të pa miratuara janë aneks i këtij procesverbali.

6. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore nr. 06/L-007 dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë nr. 06/L-008;

Kryetarja konstatoi se meqë nuk ka vërejtje nga Komisionet Kryesore, me shumicë votash procedohen për Kuvend për shqyrtim të dytë Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-007 për Procedurën jokontestimore nr. 06/L-007 dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë nr. 06/L-008;

7. Të ndryshme

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se për formimin e grupit punues për Projektligjin nr.06/L-091 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale, komisioni nxori këtë:

V e n d i m

Formohet grupi punues për Projektligjin nr. 06/L-091 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale, me këtë përbërje:

- 1) Sami Kurteshi, kryesues
- 2) Albulena Haxhiu, anëtare
- 3) Bilall Sherifi, anëtar
- 4) Korab Sejdiu, anëtar
- 5) Frashër Krasniqi, anëtar.

Një çështje tjetër për të cilën u diskutua te pika të ndryshme ishte edhe ftesa për pjesëmarrje në mbledhjen e ardhshme të Komisionit e Drejtorit të Përgjithshëm të burgjeve z. Nehat Thaçi dhe Ministrin të Drejtësisë z. Abelard Tahiri. Komisioni u dakordua që të ftohen në mbledhje të komisionit. Po ashtu u diskutua edhe për shqyrtimin e ligjeve me prioritet dhe u kërkua nga kryesuesit e grupeve punuese që të tregojnë efikasitet në respektimin e afateve të parapara për shqyrtimin e këtyre projektligjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 14:21.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu

Aneks - amendamentet e Projekt-Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074

Amendamenti 1

Në nenin 1 të Projekt - Kodit, në rreshtin e fundit, fjalët “pa dhunë penale juridike”, hiqen dhe zëvendësohen me fjalët’ pa sanksione penale të shtetit ligjor’.

Amendamenti 2

Në nenin 5 të Projekt-Kodit në rreshtin e tretë fjala ‘mohohet ose’ hiqet dhe teksti vazhdon si në Projekt- Kod.

Amendamenti 3

Neni 5 i Projekt- Kodit në rreshtin e fundit fjalët “ me të drejtën ndërkombëtare” hiqen dhe zëvendësohen me fjalët “ me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi”dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 4

Neni 15 i Projekt- Kodit, paragrafi 2 në rreshtin e gjashtë fjalët “ me të cilën ka lidhje është në marrëdhënie familjare” hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “ tjetër” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 5

Neni 16 i Projekt-Kodit, paragrafi 2 riformulohet si vijon: “ Urdhrat për të kryer gjenocid, krime lufte apo krime kundër njerëzimit janë të paligjshëm në të gjitha rrethanat.”

Amendamenti 6

Neni 27, paragrafi 2 në rreshtin e tretë pas fjalës “furnizimin” shtohen fjalët “ me mjete” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 7

Neni 42 i Projekt- Kodit, paragrafi 1 ndahet në dy paragrafët 1 dhe 2 si më poshtë:

“1.Dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se 30 (tridhjetë) ditë e as më tepër se 25 (njëzet e pesë) vjet.”

“2. Për vepra penale për të cilat ligji parasheh dënim me burgim të përjetshëm, gjykata mund të shqiptoj dënim me burgim deri në 35 (tridhjetë e pesë) vjet.” dhe paragrafi 2 bëhet 3.

Amendamenti 8

Neni 50 në titullin e nenit fjalët “të veprave të reja penale” hiqen dhe zëvendësohen me fjalët “ të veprës së re penale”

Amendamenti 9

Neni 51, në titullin e nenit fjalët “ të veprave” zëvendësohet me fjalët “ të veprës” dhe titulli i nenit vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 10

Neni 62, paragrafi 3 riformulohet si vijon:

“3. Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo funksioneve të shërbimeve publike prej 1 (një) deri në 10 (dhjetë) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat që përfshihen në Kapitullin XXXIII të këtij Kodi.

Amendamenti 11 propozim i deputetes Albulena Haxhiu me përkrahjen e komisionit

Neni 62, pas paragrafit 4 të shtohet një paragraf i ri dhe atë si vijon:

“5. Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo në shërbime publike prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet, nëse i njëjti është dënuar për dhunë familje, sipas nenit 248 të këtij Kodi.

5.1 Kur personi zyrtar dënohet me burgim efektiv, ndalesa e tillë ekzekutohet vetëm pas mbajtjes së dënimit me burgim. Për dënimin me kusht apo me gjobë, ndalesa në ushtrimin e funksionit në administratë publike apo në shërbime publike fillon të zbatohet në momentin që aktgjykimi merr formën e prerë.”

Amendamenti 12

Neni 70, në titullin e nenit fjala ‘dënimeve’ zëvendësohet me fjalën “dënimin” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 13

Neni 92, në titull të nenit, në rreshtin e parë fjala “instrumentit” zëvendësohet me fjalën “ mjeteve” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Në nenin 92 paragrafi 1 riformulohet si vijon:” Pasuria ose mjetet që janë përfitur me vepër penale konfiskohet sipas ligjit të përcaktuar në Kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës. “

Në nenin 92, paragrafi 1 riformulohet si vijon:” Pasuria ose mjete që është përfitur me vepër penale konfiskohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. “

Neni 92, paragrafi 2 në rreshtin e katërt fjala “korresponduese” zëvendësohet me fjalën “ të barasvlershme ” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 14

Titulli i nenit 93 riformulohet si vijon: **“Pasojat juridike të dënimit”**

Neni 93, paragrafi 2 në rreshtin e dytë pas fjalës “gjoba” shenja e pikësimit “,” hiqet dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 15

Neni 95, paragrafi 1 riformulohet si vijon: “1.Pas mbajtjes së dënimit me burgim,**dënimit me kusht**, faljes, **amnistisë** ose parashkrimit të dënimit, personi i dënuar i cili ka bërë dëmshpërblimin i gëzon dhe i fiton të gjitha të drejtat e përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod.

Amendamenti 16

Kapitulli XI riformulohet si vijon:

“AMNISTIA DHE FALJA

Neni 105

Amnistia dhe Falja

1. Personat të cilët janë përfshirë me amnisti ndaj tyre ndalet procedura penale, falën në tërësi ose nga një pjesë e ekzekutimit të dënimit, dënimi i shqiptuar u zëvendësohet me dënim më të butë, u abrogohet dënimi me kusht, u jepet rehabilitimi i parakohshëm ose u abrogohet pasoja e caktuar juridike e dënimit.
2. Me falje personit të caktuar me emër u jepet lirimi i plot ose i pjesërishtëm nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësimi i dënimit me një dënim më të butë apo dënimi me kusht ose shlyerja e dënimit.
3. Kryesi nuk mund të falet për çfarëdo dënim për të cilin Paneli për Lirim me Kusht i ka refuzuar lirimin me kusht.

Neni 106

Efekti i Amnistisë dhe faljes në personat e tretë

Me dhënien e Amnistisë dhe faljes nuk preken të drejtat të personit të tretë, të cilat bazohen në dënimin apo aktgjykimin.

Amendamenti 17

Neni 113, paragrafi 19, riformulohet si vijon:”19.**Dogana**-Doganat e Republikës së Kosovës përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit doganor.”

Neni 113, paragrafi 25, në rreshtin e dytë, fjalët “ të 2 (dy)” hiqen dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Neni 113, paragrafi 35 bartet pas paragrafit 25 dhe renditja e paragrafëve vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 18

Neni 116,riformulohet si vijon:”Shtetasi i Republikës së Kosovës që nënshkruan apo pranon kapitullimin ose miraton okupimin e Republikës së Kosovës apo të ndonjë pjese të saj, dënohet me burgim së paku 10 (dhjetë) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Amendamenti 19

Neni 117 riformulohet si vijon:

“Neni 117

Tradhtia ndaj vendit

1. Shtetasi i Republikës së Kosovës që në cilësinë e Presidentit të Republikës, Kryeministrit apo Ministrit të punëve të Jashtme, nënshkruan pranimin e okupimit apo aktin e kapitullimit të shtetit dënohet me burgim së paku 15 (pesëmbëdhjetë) vjet ose me burgim të përjetshëm.”

2. Shtetasi i Republikës së Kosovës që në cilësinë e Presidentit të shtetit, Kryeministrit apo ministrit të Punëve të Jashtme, nënshkruan marrëveshje ndërkombëtare ose ndonjë akt me të cilin pjesë të territorit të Republikës së Kosovës jepen apo lihen nën sovranitetin e ndonjë shteti tjetër, dënohen me burgim së paku 15 (pesëmbëdhjetë) vjet ose me burgim të përjetshëm.

3 Shtetasi i Republikës së Kosovës që në cilësinë e Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit apo ministrit të Punëve të Jashtme, braktisë vendin gjatë kohës së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme duke lënë forcat e armatosura pa sistem të komandimit dënohet me burgim së paku 15 (pesëmbëdhjetë) vjet ose me burgim të përjetshëm.”

Amendamenti 20

Neni 119, nënparagrafi 1.1, në rreshtin e parë, fjala “Kryetarin”, zëvendësohet me fjalën “Presidentin” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 21 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 128.1. i shtohet pika e re 1.20 si vijon:

1.20. Sulmi apo rrezikimi i personave intern të shpërngulur, personave të shpërngulur apo të kthyerve në Kosovë.

Amendamenti 22

Neni 128, paragrafi 4 ndahet në paragrafët 4 dhe 5 si vijon:

4. Shprehja “**grup terrorist**” nënkupton grupin e strukturuar prej më shumë se dy personave, që ekziston për një periudhe kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit.

5. **Grup i strukturuar** nënkupton një grup i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role formalisht të përcaktuara për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë ose strukturë të ndërtuar.

Paragrafi 5 bëhet 6.

Amendamenti 23 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 140. ndryshon duke ia shtuar paragrafin 7. si vijon:

7) Nuk do të iniciohet dhe udhëhiqet asnjë procedurë penale për veprën e definuar në këtë nen kundër personit të shpërngulur dhe të shpërngulur intern apo banorit të Serbisë, i cili me qëllim të mirë e viziton pasurinë dhe shtëpinë e tij që gjendet në Kosovë, me kusht që në kohën e arsyeshme lajmërohet në polici apo KFOR dhe e kumtojnë arsyen valide pse kanë kaluar përmes vendkalimit të pa autorizuar.

Amendamenti 24

Në nenin 141 titulli i nenit riformulohet si vijon “ **Nxitja e përçarjes dhe mos durimit**”

Në nenin 141, paragrafi 1 riformulohet si vijon “ Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet.

Amendamenti 25

Neni 163, paragrafi 1 në rreshtin e dytë fjalët “ përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut” hiqen dhe teksti vazhdon si në Projekt- Kod.

Amendamenti 26

Në nenin 164, paragrafi 2 në rreshtin e fundit pas fjalës gjobë shtohen fjalët “deri në 500.000 (pesëqind mijë euro) dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Neni 164, nënparagrafi 10.4, në rreshtin e fundit pas fjalës “gjobë” shtohen, fjalët “deri në 500.000 (pesëqind mijë euro).

Amendamenti 27

Titulli i nenit 168 në rreshtin e parë pas fjalës “të” shtohen fjalët “ **Organizatës së**”, dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 28 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Projekt Kodi Penal ndryshohet duke ia shtuar nenin 168 a si vijon:

Neni 168 a

Rrezikimi i personave të shpërngulur, të shpërngulurve intern dhe të kthyerve

1. Ai që me qëllim e privon nga jeta personin e shpërngulur, të shpërngulurin intern apo të kthyerin, do të dënohet me burgim me kohëzgjatje minimale prej 10 (dhjetë) vjet apo me burgim të përjetshëm.
2. Ai që kryen kidnapim apo sulm ndaj integritetit trupor apo ndaj lirisë së personit të shpërngulur, të shpërngulurit intern apo të kthyerit, do të dënohet me burgim me kohëzgjatje minimale prej 3 (tri) deri në 12 (dymbëdhjetë) vjet.
3. Ai që kryen sulm të dhunshëm ndaj hapësirave, akomodimit apo mjete transportuese të personit të shpërngulur, të shpërngulurit intern apo ndaj të kthyerit, e që ai sulm mund ta rrezikonte integritetin trupor apo lirinë e atij personi, do të dënohet me burgim me kohëzgjatje minimale prej 1 (një) deri në 10(dhjetë) vjet.
4. Ai që seriozisht kërcënon që do të kryejë veprë penale nga paragrafët 1, 2, dhe 3, do të dënohet me burgim me kohëzgjatje minimale prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjete.
5. Ai që organizon apo urdhëron tjetrin që të kryejë veprë penale nga paragrafët 1, 2, dhe 3, do të dënohet me burgim me kohëzgjatje minimale prej 3 (tre) deri në 5 (pesë) vjet.
6. Nëse me veprën penale nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, shkaktohet vdekja e një ose më shumë personave, kryerësi i veprës do të dënohet me burgim me kohëzgjatje minimale prej 10 (dhjetë) vjetësh.
7. Për nevojat e këtij neni, këto shprehje kanë këto kuptime:
 - 7.1. Shprehja " person i shpërngulur intern" nënkupton:
 - 7.1.1. Personin apo grupin e personave që kanë qenë të detyruar që të ikin apo t'i lëshojnë vendbanimet e tyre në Kosovë, në periudhën prej janarit 1998 deri në fund të marsit 2004, për shkak të konfliktit të armatosur, dhunës së përgjithshme dhe shkeljes së të drejtave të njeriut, e që janë të shpërngulur nëpër Kosovë.
 - 7.2. Shprehja " person i shpërngulur " nënkupton:

7.2.1. Personin apo grupin e personave që kanë qenë të detyruar që të ikin apo t'i lëshojnë vendbanimet e tyre në Kosovë, në periudhën prej janarit 1998 deri në fund të marsit 2004, për shkak të konfliktit të armatosur, dhunës së përgjithshme dhe shkeljes së të drejtave të njeriut, e që janë të shpërngulur jashtë Kosovës, respektivisht në rajon.

7.3. Shprehja " person i kthyer" nënkupton:

7.3.1. Personin apo grupin e personave që kanë qenë të detyruar që të ikin apo t'i lëshojnë vendbanimet e tyre në Kosovë, në periudhën prej janarit 1998 deri në fund të marsit 2004, për shkak të konfliktit të armatosur, dhunës së përgjithshme dhe shkeljes së të drejtave të njeriut, e që janë kthyer në Kosovë me qëllim të kthimit të organizuar apo individualisht.

Amendamenti 29

Neni 170, paragrafi 2, në rreshtin e dytë fjala “Shtypjen” zëvendësohet me “Shtytjen” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Neni 170, paragrafi 5 riformulohet si vijon: “5. Kushdo që kryen veprë penale nga paragrafi 1 ose 4 i këtij neni nga pakujdesia, dënohet me burgim deri në 7 (shtatë) vjet në rast se kryen veprë penale nga paragrafi 1 dhe me jo më pak se 3 (tre) vjet burgim për veprën penale nga paragrafi 4 i këtij neni.”

Amendamenti 30

Neni 180, paragrafi 2 riformulohet si vijon: “2. Kushdo që nxit ose ndihmon femrën që t'i nënshtrohet procedurave nga paragrafi 1 i këtij Neni, dënohet me burgim deri në 3 (tre) vjet.

Neni 180 , numri i paragrafi 4, bëhet “3”.

Amendamenti 31

Neni 184, paragrafi 1, në rreshtin dytë, hiqen fjalët “pa pëlqimin e atij personi” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 32

Në nenin 190, paragrafi 1 riformulohet si vijon: “ Kushdo që për shkak të përkatësisë kombëtare apo etnike, racës, fesë, apo për shkak që nuk i përket ndonjërisë përkatësi, apo për shkak të bindjeve politike ose bindjeve të tjera, gjinisë, invaliditetit, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës arsimit, pozitës shoqërore, prejardhjes sociale, gjendjes materiale, apo ndonjë karakteristike tjetër personale, tjetrit ia mohon ose kufizon të drejtat e përcaktuara me Kushtetutë, ligj ose dispozita të tjera, akte të tjera të përgjithshme ose marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare, apo i jep privilegje apo favore bazuar në këto dallime, dënohet me burgim deri në 3 vjet.

Amendamenti 33 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 190. 2. ndryshon si vijon:

..... do të dënohet me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh.

Amendamenti 34 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 190. 3. ndryshon si vijon:

..... do të dënohet me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh.

Amendamenti 35 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 191. 2. i shtohet 2.5 si vijon:

Kryerësi veprën e ka kryer ndaj personit të shpërngulur intern, personit të shpërngulur apo ndaj të kthyerit.

Amendamenti 36 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 192. 2. i shtohet 2.5 si vijon:

Kryerësi veprën e ka kryer ndaj personit të shpërngulur intern, personit të shpërngulur apo ndaj të kthyerit.

Amendamenti 37 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 193. 2. i shtohet 2.6 si vijon:

Kryerësi veprën e ka kryer ndaj personit të shpërngulur intern, personit të shpërngulur apo ndaj të kthyerit.

Amendamenti 38 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 196. 3. ndryshon si vijon:

Kur vepra penale nga paragrafi 1.i këtij neni kryhet ndaj personit të shpërngulur intern, personit të shpërngulur apo ndaj të kthyerit, kryerësi do të dënohet me burgim me kohëzgjatje prej 3 (tri) deri në 8 (tetë) vjet.

Amendamenti 39

Në nenin 212, paragrafi 5 riformulohet si vijon: “ Dhurata apo përfitimi i pranuar apo i afruar në kundërshtim me këtë nen konfiskohet”.

Amendamenti 40

Në nenin 219, paragrafi 1 në rreshtin e tretë pas fjalës “siç” fjala “që” hiqet dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 41

Në nenin 222, paragrafi 1 riformulohet si vijon : “Kushdo që kundërshtim me ligjin organizon ose udhëheq grevën edhe nëse nuk ka elemente të ndonjë veprë tjetër penale dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1(një) vit.

Në nenin 222, paragrafi 2 në rreshtin e parë fjalët “ *në shkelje të ligjit*” zëvendësohen me fjalët “*në kundërshtim me ligjin*” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 42

Në nenin 225, paragrafi 3 në rreshtin e parë fjala “ Asgjë” zëvendësohet me fjalët “ Asnjë veprim” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 43

Në nenin 227, paragrafi 8 në rreshtin e dytë fjala “*nën*” hiqet dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 44

Në nenin 239, paragrafi 3 në rreshtin e dytë fjala “adoptees” zëvendësohet me fjalën “adoptues” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 45 dy propozime

A. Propozim i Komisionit

“Në nenin 248 riformulohet si vijon:

Neni 248

Dhuna në familje

1. Kushdo që ushtron keqtrajtim fizik ose psikik apo presion ekonomik, me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare dënohet me burgim prej 3 muaj deri në 3 (tre) vjet.

2. Për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni:
 - 2.1. Kryesi konsiderohet se ka ushtruar presion ekonomik ndaj personit me të cilin është në marrëdhënie familjare nëse përmes presionit, dhunës apo keqtrajtimit ia mohon mjetet e domosdoshme për jetesë, ia ndalon punësimin apo përmes formave të ndryshme mundohet ta mbajë në pozitë të varur ekonomike.
 - 2.2. Kryesi konsiderohet se ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj personit me të cilin është në marrëdhënie familjare nëse ushtron presion të vazhdueshëm psikik përmes frikësimit, izolimit apo formave të ngjashme të kontrollit ose presionit psikik.
3. Të gjitha veprat tjera penale të parapara me këtë Kod, të cilat sanksionojnë veprat e kryera brenda marrëdhënies familjare dhe të cilat përfshijnë forma të dhunës fizike, psikologjike, seksuale apo ekonomike, do të konsiderohen njëkohësisht edhe vepra në kontekst të këtij neni. Për ato vepra vlen sanksioni përkatës sipas neneve relevante dhe të njëjtat do të kenë përparësi ndaj këtij neni.

B. Propozim i Grupit të Grave Deputete pa përkrahjen e komisionit

Aktualisht dispozita e nenit 248 është e përkufizuar si më poshtë (po markoj pjesët që janë hequr apo ndryshuar):

1. Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet.
2. Kur çfarëdo vepre në Kodin Penal kryhet brenda marrëdhënies familjare, do të konsiderohet si rrethanë rënduese.
 1. Çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet.
 - 1.2 “Marrëdhënia familjare” për nevojat e kësaj dispozite është në përputhshmëri me përkufizimin në nenin 113 të këtij kodi.
 - 1.3 Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e këtij kodi do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 03/L-182 për mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Ose përkufizimi sipas “Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”

“dhunë në familje” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish- bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën”

Amendamenti 46

Në nenin 259, paragrafi 6 në rreshtin e gjashtë lidhëza “ose” zëvendësohet me lidhëzën “dhe” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 47

Në nenin 261, në titullin e nenit në rreshtin e dytë fjala “ushqimor” zëvendësohet me fjalën “ushqimorë”.

Amendamenti 48

Në nenin 277, paragrafi 1 në rreshtin e gjashtë pas fjalës të dënueshme “hiqet presja” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 49 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 284. ndryshon duke ia shtuar paragrafin 3. si vijon:

3) Nuk do të iniciohet dhe udhëhiqet asnjë procedurë penale për veprën e definuar në këtë nen kundër personit përgjegjës që punon te personi juridik, që i është i regjistruar dhe funksionon në sistemin e Serbisë, deri sa funksionimi i personave të theksuar juridikë nuk rregullohet në bazë të marrëveshjeve në mes Prishtinës dhe Beogradit.

Amendamenti 50 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 299. ndryshon duke ia shtuar paragrafin 5. si vijon:

5) Nuk do të iniciohet dhe udhëhiqet asnjë procedurë penale për veprën e definuar në këtë nen kundër personit përgjegjës që punon te personi juridik e që janë të regjistruar dhe funksionojnë me sistemin juridik të Serbisë, deri sa kjo çështje të rregullohet në dialogun nëmes të Prishtinës dhe Beogradit.

Amendamenti 51 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 307. ndryshon duke ia shtuar paragrafin 4. si vijon:

4) Nuk do të iniciohet dhe udhëhiqet asnjë procedurë penale për veprën e definuar në këtë nen kundër personit përgjegjës që punon te personi juridik,e që janë të regjistruar dhe funksionojnë me sistemin juridik të Serbisë, deri sa kjo çështje të rregullohet në dialogun nëmes të Prishtinës dhe Beogradit.

Amendamenti 52

Në nenin 314, paragrafi 2 në rreshtin e tretë lidhëza “dhe” zëvendësohet me lidhëzën “ose” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 53 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Nenit 315. 1. i shtohet 1.5 si vijon:

1.5. vepra e kryer ndaj pasurisë së personave të shpërngulur intern dhe personave të shpërngulur, si dhe të kthyerve.

Amendamenti 54 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Nenit 320. 2. i shtohet 2.3 si vijon:

2.3. nëse është uzurpuar prona e paluajtshme e personave të shpërngulur dhe të shpërngulurve intern dhe e të kthyerve.

Amendamenti 55 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Nenit 320. i shtohet paragrafi 4. si vijon:

Kryerësi do të dënohet me burgim me kohëzgjatje prej së paku 5 (pesë) vjet, në rast të uzurpimit të përsëritur të pasurisë së personit të shpërngulur intern, personit të shpërngulur apo të kthyerit.

Amendamenti 56 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Nenit 320. i shtohet paragrafi 5. si vijon:

Për veprën penale nga pika 4 e këtij neni, nuk lejohet zbutje e dënimit.

Amendamenti 57

Në nenin 321, paragrafi 1 në rreshtin tretë pas fjalëve “dënohet me” shtohen fjalët “*gjobë ose*” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 58 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Nenit 322. i shtohet paragrafi 5. si vijon:

Ai që i vë zjarrin apo shkakton eksplozim me qëllim të dëmtimit të pronës së personit të shpërngulur intern, personit të shpërngulur apo të kthyerit, kryerësi do të dënohet me burgim me kohëzgjatje prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet.

Amendamenti 59

Neni 325 riformulohet si vijon:

“Neni 325

Mashtrimi lidhur me pranimin e fondeve nga Komuniteti Ndërkombëtar

1. Kushdo që qëllimisht përdor ose paraqet deklarata apo dokumente të rrejshme, të pasakta apo jo të plota dhe si rezultat i këtij veprimi pranon ose merr fonde në mënyrë të kundërligjshme nga cilido vend i huaj, ose nga ndonjë agjenci apo entitet ndërkombëtar dënohet me burgim prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet.”

2. Kushdo që fsheh të dhëna në shkelje të detyrimit të posaçëm për zbulimin e të dhënave të tilla dhe si rezultat i kësaj pranon apo mban në mënyrë të kundërligjshme fonde nga cilido vend i huaj, ose nga ndonjë agjenci apo entitet ndërkombëtar dënohet me gjobë ose me burgim prej 1 (një) deri në 3 (tre) vjet.

3. Kushdo që përdor fondet nga cilido vend i huaj, ose nga ndonjë agjenci apo entitet ndërkombëtar ose cilitdo vend të huaj për tjera qëllime nga ato për të cilat janë dhënë, dënohet me burgim prej 2 (dy) deri në 8 (tetë) vjet.”

Amendamenti 60

Nenin 349 riformulohet si vijon:

“Neni 349

Vjedhja e pyllit

1. Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e druve të prerë tejkalon 2 metra kub, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me qëllim të shitjes, ose sasia e druve të prerë tejkalon 5 (pesë) metra kub, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej 3 (tre) muaj deri në 4 (katër) vjet.

3. Nëse vepra penale nga ky nen kryhet:

3.1 në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm;

3.2 me qëllim që drunjtë e prerë të shiten, pavarësisht sasisë së drurit të përfshirë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet.

4. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.

Amendamenti 61 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 349. ndryshon duke ia shtuar paragrafin 4. si vijon:

5. Nëse vepra penale është kryer në pyllin që është në pronësi të personave të shpërngulur intern, të shpërngulur apo pyllin e të kthyerve.

Amendamenti 62

Në nenin 359, paragrafi 5 në rreshtin e parë fjala “nën” zëvendësohet me fjalën “në” dhe në rreshtin e dytë fjala “në “ zëvendësohet me fjalën “te” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 63 propozim i Grupit Parlamentar Lista Srpska, pa përkrahjen e komisionit

Neni 359. ndryshon duke ia shtuar paragrafin 5. si vijon:

5. Nëse vepra penale nga paragrafët 1, 2, dhe 3. Të këtij neni, është kryer në pronën e personave të shpërngulur intern, të shpërngulur apo pyllin e të kthyerve, kryerësi do të dënohet me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vjet.

Paragrafi aktual 5. i këtij neni, bëhet paragrafi 6.

Amendamenti 64

Në nenin 361, paragrafi 1 në rreshtin e fundit pas fjalës “një” shtohet numri “(1)” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 65

Në nenin 364, paragrafi 1 në rreshtin e parë fjala “shkelje” zëvendësohet me fjalën “kundërshtim” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 66

Në nenin 366, paragrafët 1 dhe 3 në rreshtin e dytë fjala “shkelje” zëvendësohet me fjalën “kundërshtim” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod

Amendamenti 67

Në nenin 367, paragrafët 1 dhe 3 në rreshtin e dytë fjala “shkelje” zëvendësohet me fjalën “kundërshtim” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 68

Titulli i nenit 368 në rreshtin e dytë fjala “te” zëvendësohet me fjalën “të” dhe titulli vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 69

Në nenin 370, paragrafi 3 pas fjalës “nga paragrafi” shtohet numri “1 ose” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 70

Në nenin 371, paragrafi 1 në rreshtin e gjashtë pas fjalës “dehëse” shtohen fjalët “ nëse shkaktohet aksident” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 71 propozim i deputetes Albulena Haxhiu me përkrahjen e Komisionit

Në nenin 388, pas paragrafit 1 të shtohet një paragraf i ri dhe atë si vijon:

2. Kushdo që ndërmerri ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person me qëllim të hakmarrjes për shkak të raportimit ose shpalosjes së informacionit për veprimet dhe mosveprimet që paraqesin kërcënim ose cenim të interesit publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 (dy) vjet.

Amendamenti 72 propozim i deputetes Albulena Haxhiu me përkrahjen e Komisionit

Në Kapitullin XXXIII - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, pas nenit 414 të shtohet një nen i ri dhe atë si vijon:

Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik

1. Kushdo që me vetëdije shkel rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokumentacion të rremë, marrëveshje të fshehtë kundërligjore apo ndërmerri ndonjë veprim tjetër të paligjshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe më qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik, dënohet me gjobë dhe burgim deri në 5 (pesë) vjet.
2. Personat përgjegjës apo kushdo i cili më qëllimisht dhe duke shkelur procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, nuk zbatojnë detyrimet që dalin nga kontrata e prokurimit publik me qëllim të përfitimit për vete apo duke shkaktuar dëme buxhetore, nëse karakteristikat e veprave të tjera penale nuk janë përmbushur, dënohet me gjobë dhe burgim deri në 5 (pesë) vjet.
3. Nëse kryerësit e veprave penale nga paragrafët 1 dhe 2 i këtij neni, përfitojnë ose shkaktajnë dëme të konsiderueshme pasurore, në vlerat mbi 5,000 (pesëmijë euro), atëherë kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vjet.
4. Në rastet e shpalljes fajtor të kryerësit, përveç dënimit, gjykata do t'i shqiptojë kryerësit ndalimin e marrjes pjesë në procedurat për dhënien e kontratave në prokurim publik.

Amendamenti 73

Në nenin 416, paragrafi 5 në rreshtin e dytë fjala “më” zëvendësohet ne fjalën “me” dhe teksti i vazhdon se në Projekt-Kodit.

Amendamenti 74

Titulli i nenit 422 në rreshtin dytë fjalët “personi të huaj” zëvendësohet me fjalët “ personave të huaj” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 75

Në nenin 422, paragrafi 4 në rreshtin e dytë fjala “ shkelje” zëvendësohet me fjalën “ kundërshtim” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 76

Në nenin, 423 paragrafi 3 në rreshtin e dytë fjala “ shkelje” zëvendësohet me fjalën “ kundërshtim” dhe teksti vazhdon si në Projekt-Kod.

Amendamenti 77

Neni 433 riformulohet si vijon:

“Kodi Penal i Republikës së Kosovës hyn në fuqi tre (3) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”.

Aneks - amendamentet e Projektligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

Amendamenti 1

Neni 2, nënparagrafi 1.5, riformulohet si vijon:”1.5 **Vepër e rëndë penale**”, nënkupton veprat penale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.”

Amendamenti 2

Neni 5, nënparagrafi 1.2, fjalët “me dashje”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 3

Neni 5, nënparagrafi 2, në rreshtin e parë, fjalët “e rëndë”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 4

Në nenin 5, nënparagrafët 2.7, 2.12,2.14 dhe në nenin 6, nënparagrafi 2.10, fjala “Vazhdimisht”, zëvendësohet me fjalët “Në vazhdimësi” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 5

Neni 5, nënparagrafi 2. 8, riformulohet si vijon:” 2.8 Përfshihet në çfarëdo komunikimi ex-parte, lidhur me lëndët.”

Amendamenti 6

Neni 5, nënparagrafi 2.16, në rreshtin e parë, fjala “parti”, zëvendësohet me fjalën “subjekt” dhe në rreshtin e dytë, fjala “lëvizje”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 7

Neni 6, nënparagrafi 1.2, fjalët “me dashje”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 8

Neni 6, nënparagrafi 2.1, në rreshtin e pestë, fjalët “në afatet”, zëvendësohen me fjalët “brenda afateve” dhe në rreshtin e nëntë, fjalët “këtë shkelje”, zëvendësohen me fjalët “një shkelje të vetme;”

Amendamenti 9

Neni 6, nënparagrafi 2.3, riformulohet si vijon:”2.3 Komunikon me personat e paautorizuar informacionin konfidencial të marrë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.”

Amendamenti 10

Neni 6, nënparagrafi 2.5, hiqet dhe renditja e nënparagrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 11

Neni 6, nënparagrafi 2.6, riformulohet si vijon: “2.6 Nuk merr parasysh të drejtat e dëshmitarëve ose palëve të dëmtuara, veçanërisht për të marrë masa për të mbrojtur jetën, sigurinë dhe privatësinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Amendamenti 12

Neni 6, nënparagrafi 2.12, në rreshtin e tretë, fjala “duhet”, zëvendësohet me fjalën “duket” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 13

Neni 6, nënparagrafi 2.14, fjalët “parti politike, lëvizje,” zëvendësohen me fjalët “subjekt politik” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 14

Neni 7, paragrafi 4, riformulohet si vijon: “4. Me përjashtim të vërejtjes jopublike, të gjitha vendimet përfundimtare mbi sanksionet disiplinore publikohen pa vonesë, por jo më vonë se 15 ditë nga këshillat përkatës në faqen e tyre zyrtare.”

Amendamenti 15

Neni 8, paragrafi 1, në rreshtin e pestë, fjala “propozojë”, zëvendësohet me fjalën “propozon” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 16

Neni 9, nënparagrafi 1.1, pas fjalës “Themelore”, shtohen fjalët “dhe të Apelit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 17

Neni 9, nënparagrafi 1.7, bëhet si paragraf 2 dhe fjala “Atëherë”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 18

Në nenin 9, paragrafët 2, 4,5, neni 11, paragrafi 1, neni 12, paragrafët 3 dhe 5, neni 14 paragrafi 5, neni 15, paragrafët 1 dhe 2, fjalët “Ministri i Drejtësisë”, hiqen dhe fjalët përshtaten në kontekst të fjalisë.

Amendamenti 19

Neni 12, paragrafi 5, riformulohet si vijon:” 5. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të punës nga marrja e kërkesës për fillimin e hetimeve disiplinore, Këshilli themelon një panel hetimor për kryerjen e hetimeve. Në rastet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, Këshilli mund të hedhë poshtë kërkesën, pa formuar panelin hetues, në qoftë se konsideron që është prima facie pa vlerë apo pa rëndësi serioze, jo substanciale, nuk ka lidhje me shkeljen disiplinore apo është parashkruar. Paneli hetimor, për sa i përket një gjyqtari, përkatësisht kryetarit të gjykatës, përbëhet nga tre gjyqtarë të një gjykate tjetër. Paneli hetimor, për sa i përket një prokurori, përkatësisht kryeprokurori për prokurorët, përbëhet nga tre prokurorë të një organi tjetër prokurorial. Këshilli përcakton kryesuesin e panelit hetimor nga radhët e anëtarëve të panelit hetimor. Procedura për përzgjedhjen dhe caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të shërbyer në panel hetimor, përcaktohet nga këshillat. Këshilli siguron ndihmë administrative dhe profesionale për panelin hetimor.

Amendamenti 20

Neni 12, paragrafi 8, në rreshtin e tetë, fjala “Komisioni”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj. Ndërsa, në fund të paragrafit, pas fjalëve “funksionin e vet”, shtohen fjalët“në momentin kur rasti bëhet i formës së prerë.”

Amendamenti 21

Në nenin 13, paragrafët 1,2 dhe 3, fjala “ Këshilli/t”, zëvendësohet me fjalët “paneli hetimor” .

Amendamenti 22

Neni 14, paragrafi 1, në rreshtin e gjashtë, fjalët “ 14 (katërbëdhjetë) ditësh”, zëvendësohen me fjalët “ 30 (tridhjetë) ditësh” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 23

Neni 14, paragrafi 2, fjalët “Ai apo ajo do të ketë”, zëvendësohen me fjalët “Këshilli obligohet t’i ofrojë”dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 24

Neni 14, paragrafi 4, në rreshtin e katërt, pas fjalës “anëtarëve”, shtohet fjala “të pranishëm”.

Amendamenti 25

Neni 14, paragrafi 5, në rreshtin e nëntë, fjalët “Vendimi do të publikohet në faqe të Këshillit, pasi të bëhet final”, zëvendësohen me fjalët “*Vendimi i shkallës së parë do të publikohet në faqe të Këshillit, pasi të bëhet i formës së prerë.*”

Amendamenti 26

Në nenin 15, titulli i nenit riformulohet si vijon: “**Ankesa ndaj vendimeve disiplinore**”.

Neni 15, paragrafi 1, riformulohet si vijon: “1. Palët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit. Gjykatat tjera në Kosovë, nuk kanë kompetencë të shqyrtojnë dhe të vendosin lidhur me procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.”

Në neni 15, pas paragrafit 1, shtohet një paragraf i ri, me përmbajtjen si vijon: “Ankesa ndaj vendimit të Këshillit ka efekt suspensiv dhe ndalon implementimin e atij vendimi, derisa të shqyrtohet ankesa”.

Në nenin 15, paragrafi 4, në rreshtin e katërt, fjalët “brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve”, hiqen dhe zëvendësohen me fjalët “brenda 30 (tridhjetë) ditëve” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 15, paragrafi 7, në rreshtin e dytë, fjalët “brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve”, hiqen dhe zëvendësohen me fjalët “brenda 30 (tridhjetë) ditëve” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 15, pas paragrafit 8, shtohet një paragraf i ri 9, me përmbajtjen si vijon: “9. Përbërja e trupit gjykues pranë Gjykatës Supreme sipas paragrafit 4 të këtij neni dhe ai i panelit hetimor sipas nenit 12, paragrafi 5, nuk duhet të përbehet nga anëtarët të cilët janë subjekt i procedurave disiplinore.”

Amendamenti 27

Neni 16, riformulohet si vijon:

Neni 16 Transferimi i personelit

“1. Personeli i Zyrës së Prokurorit Disiplinor do të transferohet në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, me qëllim të ofrimit të mbështetjes për panelet hetimore në zhvillimin e hetimeve disiplinore, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.”

“2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, brenda 3 (tre) muajve nga data e bartjes së stafit, do të zyrtarizojnë obligimet kontraktuale me stafin e bartur.”

Amendamenti 28

Neni 17, riformulohet si vijon:

Neni 17 Dispozitat kalimtare

1. Këshillat miratojnë rregulloret e parapara me këtë ligj, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

2. Procedurat hetimore të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vendosen dhe përfundojnë në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi, në kohën kur ka filluar hetimi dhe do të përfundojnë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Procedurat disiplinore të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë dhe përfundojnë në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi, në kohën e fillimit të hetimit disiplinor dhe do të përfundojnë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha ankesat lidhur me shkeljet e supozuara disiplinore, përfshirë ato që pretendohet të jenë kryer para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por për të cilat nuk ka filluar hetimi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të procedohen nga autoritetet kompetente dhe këshillat, në pajtim me këtë ligj.
5. Afatet e parapara në nenin 9, nenin 12 dhe nenin 14 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
6. Gjatë periudhës tranzitore, sipas këtij neni, këshillat kanë autoritetin që ex officio të suspendojnë një gjyqtar apo prokuror, bazuar në seriozitetin e shkeljes disiplinore të supozuar.

